

18 prill 2014, Prizren

## KOMUNIKATË

### EC Ma Ndryshe përmbyll fazën e parë të dorëzimit të shkresave të pranuar nga qytetarët

Pas punës disa mujore në hartimin dhe zhvillimin e idesë, si dhe funksionalizimin dhe promovimin e platformës për pjesëmarrje përmes mediave sociale në vendimmarrjen e komunës së Prizrenit, OJQ EC Ma Ndryshe, të premtën, ka përmbyll fazën e parë të dorëzimit të shkresave të pranuar nga qytetarët.

Propozimet për buxhet respektivisht investime kapitale, ankesat e ndryshme dhe e-peticionet e pranuar përmes platformës online [www.merrpjese.org](http://www.merrpjese.org), janë adresuar tek organet përgjegjëse komunale.

Më saktësisht të premtën në Komunën e Prizrenit janë dorëzuar 9 propozime për projekte kapitale në shkollë, lagje e qytet, të cilat i janë drejtuar secilës drejtori përkatëse.

Propozimet që janë protokolluar sot në Komunë dhe në Drejtorinë për Ekonomi dhe Financa, janë:

- Kosha për mbeturina (Hamam-Bazhdarhane);
- Të ndërtohet një sallë sportive (Sh.f.m.u. "Lidhja e Prizrenit");
- Ndërtimi i rrugës dhe urës (në Gornje Selo);
- Ndërrimi i gypave të ujës-jellësit;
- Asfaltimi i një rruge pa dalje( rruga "Tefik Qanga");
- Rregullimi i parkut (rruga "Besnik Muçaj");
- Shtëpia e pleqve;
- Parku në lagjen Dardania;
- Ndërtim rruge (ish medreseja " Alaudin")

Të gjitha shkresat që janë protokolluar në komunë i janë drejtuar drejtorëve të drejtorive përkatëse, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës dhe Zyrtarit për Informim pranë Kuvendit Komunal.

Po ashtu 13 ankesa lidhur me çështje të ndryshme janë dorëzuar në komunë, që i janë adresuar Kryesuesit të KK-së, Zyrtarit për Informim dhe drejtorive përkatëse, derisa ankesa lidhur me qentë endacakë përveç në DSHP është dorëzuar edhe në Polici.

Ndërkaq 4 peticione elektronike janë dorëzuar në komune, që i janë drejtuar Kryesuesit të KK-së, Zyrtarit për Informim dhe drejtorive përkatëse, me ç'rast 3 e-peticione janë protokolluar direkt në DKA si:

- Kërkohe kabinet i informatikës në Gjimnazin "Remzi Ademaj";
- Kërkojmë laborator në shkollë;
- Të ndërpritet praktika e grumbullimit të hollave nga nxënësit për sigurimin fizik të shkollave.

**OJQ Emancipimi Civil Ma Ndryshe (EC Ma Ndryshe)**

Rr. Saraqët 5, 20000/Prizren ~ Rr. Perandori Dioklician, 14, kati V (te Qafa), 10000/Prishtinë  
[www.ecmandryshe.org](http://www.ecmandryshe.org) ~ [info@ecmandryshe.org](mailto:info@ecmandryshe.org) ~ 038-224-967 & 029-222-771

EC Ma Ndryshe përmes kësaj forme inovative të artikulimit të kërkesave dhe vullnetit të qytetarëve, synon që të rris pjesëmarrjen e tyre në vendimmarrje dhe njëkohësisht të shtyjë organet komunale që të veprojnë në përputhje me interesat e shprehura drejtpërdrejtë nga qytetarët.

Platforma online [www.merrpjese.org](http://www.merrpjese.org) , është prodhuar nga EC Ma Ndryshe, në kuadër të projektit “Rritja e pjesëmarrjes në vendimmarrje përmes medieve sociale”, përkrahur nga UNDP.

Me respekt,

Laura Lutfiu, koordinatore projekti

OJQ EC Ma Ndryshe

Rr. Saraqët 5, 20000 Prizren & Rr. Perandori Dioklician, 14, kati V (te Qafa), 10000 Prishtinë

[www.ecmandryshe.org](http://www.ecmandryshe.org) & [info@ecmandryshe.org](mailto:info@ecmandryshe.org)

[laura.lutfiu@ecmandryshe.org](mailto:laura.lutfiu@ecmandryshe.org)

+381 38 224 967 & +381 29 222 771

**OJQ Emancipimi Civil Ma Ndryshe (EC Ma Ndryshe)**

Rr. Saraqët 5, 20000/Prizren ~ Rr. Perandori Dioklician, 14, kati V (te Qafa), 10000/Prishtinë

[www.ecmandryshe.org](http://www.ecmandryshe.org) ~ [info@ecmandryshe.org](mailto:info@ecmandryshe.org) ~ 038-224-967 & 029-222-771